



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1276/ 6 prot.

Datë 20/05/2026

V E N D I M
Nr. 676/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20/05/2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “*MIKI CONSULTING SHPK & ERALD-G SHPK*” në procedurën e prokurimit “*E hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. *REF-79637-03-19-2026* me objekt “*Mbikqyrja e punimeve për objektin: Rikualifikim urban bllok pallatesh rruga e “Tafiliceve” (Faza e parë)*”, me fond limit 258.833 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

Ankimues: Operatori ekonomik “*MIKI CONSULTING*” SHPK me NIPT: K87628701K, dhe me adresë: *Lagjja “Vasil Shanto”, Rruga “Vaso Kadia”, godinë nr 1/506, Shkodër.*

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Shkodër
Adresa: Rr. “13 Dhjetori”, Nr.1, Shkodër

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit*”

publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020, datë 05.11.2020 “*Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nëni kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar si dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 24.03.2026, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*E hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-79637-03-19-2026 me objekt “*Mbikqyrja e punimeve për objektin: Rikualifikim urban bllok pallatesh rruga e “Tafiliceve” (Faza e parë)*”, me fond limit 258.833 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

II.2. Në datën 03.04.2026 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt-ankimi.

II.3. Më datë 15.04.2026 autoriteti kontraktor ka kryer vlerësimin e ofertave si vijon:

1	“NOVATECH STUDIO” SHPK	218.392 leke	kualifikuar
2	BOE “Besart Ylli PF & XH & amp; MILER SHPK”	218.392 leke	kualifikuar
3	“LENI-ING” SHPK	218.392 leke	kualifikuar
4	BOE “BN PROJECT SHPK & HYDRO-ENG CONSULTING SHPK”	218.392 leke	skualifikuar
5	BOE “Erald G SHPK & MIKI CONSULTING SHPK”	218.392 leke	skualifikuar
6	“PROJECT DALUZ 2019” SHPK	219.857 leke	kualifikuar

II.4. Në datën 15.04.2026, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Erald G SHPK & MIKI CONSULTING SHPK” është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentat, si më poshtë vijon:

“Nuk permbushen kriteret si me poshte: Operatori ekonomik “MIKI CONSULTING” Shpk Te FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT pika B Deklaratë Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen) Deklaron se disponon: 1 (një) inxhinier hidroteknik dhe jo inxhinier ndërtimi 1 (një) inxhinier topograf OE “MIKI CONSULTING” Shpk.nuk permbushë kriteret sipas pikes 2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë: 1 (një) inxhinier ndërtimi 1 (një) inxhinier elektrik 1 (një) inxhinier topograf Ne rastin e bashkimit te operatorve secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

II.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) konstatohet se më datë 22.04.2026, autoriteti kontraktor publikuar njoftimin e fituesit paraprak duke shpallur fitues oferten e shoqërisë “NOVATECH STUDIO” SHPK.

II.6. Njëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2026/6586, datë 26.04.2026 dhe me numër protokoll nr. 1276/2026, datë 27.04.2026 e bashkimit të operatorëve ekonomikë “MIKI CONSULTING SHPK & ERALD-G SHPK” në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-79637-03-19-2026 me objekt

“Mbikqyrja e punimeve për objektin: Rikualifikim urban bllok pallatesh rruga e “Tafiliceve” (Faza e parë)”, me fond limit 258.833 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë *“MIKI CONSULTING SHPK & ERALD-G SHPK”*, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Në përputhje me nenin 112 *“Veprimet paraprake”* të Ligjit nr.162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit me Nr. 1276/1 Prot datë 28.04.2026, në lidhje me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë *“MIKI CONSULTING SHPK & ERALD-G SHPK”*, në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.8. Në datë 30.04.2026, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën nr. 9938/4 prot, datë 30.04.2026, protokolluar me tonën me nr. 1276/2 prot, datë 30.04.2026, ku është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave për trajtimin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë *“MIKI CONSULTING SHPK & ERALD-G SHPK”*, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë *“MIKI CONSULTING SHPK & ERALD-G SHPK”* mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi si në vijim: *“Nuk permbushen kriteret si me poshte: Operatori ekonomik “MIKI CONSULTING” Shpk Te FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT pika B Deklaratë Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen) Deklaron se disponon: 1 (një) inxhinier hidroteknik dhe jo inxhinier ndërtimi 1 (një) inxhinier topograf OE “MIKI CONSULTING” Shpk.nuk permbushë kriteret sipas pikes 2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të*

disponojë personelin kryesor, si më poshtë: 1 (një) inxhinier ndërtimi 1 (një) inxhinier elektrik 1 (një) inxhinier topograf Ne rastin e bashkimit të operatorve secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në pikën 2.1.a “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT” dhe pikën 2.3.3 “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 9 “FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues, si më poshtë:

“2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

1 (një) inxhinier ndërtimi

1 (një) inxhinier elektrik

1 (një) inxhinier topograf

Inxhinieret e mësipërm duhet të jetë i licensuar për kategoritë e kërkuara, të vërtetuar me Licence profesionale të shoqërisë ose Licence individuale, kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.”.

III.1.2. Në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka publikuar Shtojcën 10 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT”, si më poshtë:

Shtojca 10.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
---------------------	------------------

Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	1. -----
2. Numri NIPT/et:	3. -----
4. Adresa postare: 5. Qyteti / qyteti; Kodi postar	6. -----
7. Përfaqësuesi (emri):	8. -----
9. Telefoni:	10. -----
11. E-mail:	12. -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

• **Informacione për nënkontraktorin**

<i>Emri i nënkontraktorit të propozuar</i>	<i>NIPT –i</i>	<i>Përqindja e nënkontraktimit</i>	<i>Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar</i>

• **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

<i>Emri (at) e subjekteve</i>	<i>NIPT-i</i>	<i>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</i>	<i>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</i>

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata				
13.	Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.			
14.	Sqarimenëse	vlerësohet	e	nevojshme
<hr/>				
15.	Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.			
16.	Sqarime	nëse	vlerësohet	e nevojshme
<hr/>				
17.	Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:			
18.				
19.	etj.			
20.	nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.			
21.	Sqarime	nëse	vlerësohet	e nevojshme
<hr/>				
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi				
22.	Sqarime	nëse	vlerësohet	e nevojshme
<hr/>				
23.	Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).			
24.	Sqarime	nëse	vlerësohet	e nevojshme
<hr/>				

25.	<i>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</i>				
26.	<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
27.	<i>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</i>				
28.	<i>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</i>				
29.	<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<i>Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.</i>					
<i>Sqarime nëse vlerësohet nevojshme _____</i>					
30.					
<i>Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.</i>					
31.	<i>qarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i>				
<i>Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.</i>					
<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i>					
32.	<i>operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</i>				
33.	<i>operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</i>				
34.	<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>

35.

peratori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

36.

qarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se:

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër¹.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

çmimet;

metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;

qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,

paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA “Mbi Konfliktin e Interesit”

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë

¹ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

- Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

*Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.***

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA "Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës"

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik_____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimin të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: <hr/> <u>Profili i punonjësve</u> <hr/> <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo []

<i>sqarime nga autoriteti kontraktor.</i>	<i>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</i>
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- *Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.*
- *Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.*
- *Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak dhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.*
- *Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.*

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- *Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.*
- *Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.*
- *Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për dokumentat e ofertës të ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara. Ndërsa, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar*

vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.

- *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se bashkimi i operatorëve ekonomikë “*MIKI CONSULTING SHPK & ERALD-G SHPK*” për përmbushjen e kriterëve kualifikuese të sipërpërmendura ka dorëzuar në dokumentacionin, si më poshtë vijon:

- Kontratë bashkëpunimi datë 27.03.2026, të lidhur ndërmjet shoqërisë “*MIKI CONSULTING*” SHPK dhe shoqërisë “*Erald G*” SHPK , ku ne Nenin 1 “*Qëllimi i kontratës*” dhe në Nenin 4 “*Kontributet e palëve*” deklarohet si më poshtë vijon:

Neni 1

Qëllimi i Kontratës:

Qëllimi i kësaj kontratë është të sanksionojë këtë marrëveshje ndërmjet 2(dy) palëve të mësipërme përmes përfaqësuesve ligjor të tyre, për krijimin e bashkimit të përkohshëm të shoqërive me qëllimin mbikëqyrjen e punimeve per objektin: Mbikëqyrja e punimeve për objektin

Neni 4

Kontributet e Palëve

Palët kanë rënë dakort që përqindja e pjesëmarrjes për realizimin e Objektit të mësipërm të jetë si më poshtë:

❖ “*Miki Consulting*” sh.p.k, Z. Gjeto Dukaj ne 51% i cili pergjigjet për udhëheqjen dhe menazhimin e kesaj Kontrate dhe per stafin inxhinierik:

Stafi :

✓ *Ing. Gjeto Dukaj, Administrator, dhe Drejtues Teknik ne License, Inxhinier Hidroteknik*

✓ *Ing. Gafur Ternova – Drejtuese Teknike , Inxhinier Topograf*

✓ *Stafi ndihmes, mjetet e transportit, zyra, mjetet teknike dhe gjithë infrastruktura logjistike*

❖ «*Erald –G*» sh.p.k Z. Gezim ISLAMI ne 49% i cili pergjigjet per stafin inxhinierik:

Stafi :

✓ *Ing. Gezim Islami- Drejtues Teknik, Inxhinier Ndertimi*

✓ *Ing. Artan Mitrushi – Drejtues Teknik, Inxhinier Elektrik*

*Me qellim plotesimin e gjithë kushteve DST te ketij objekt prokurimi, dhe ne vecanti: kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3. Kapaciteti teknik si dhe duke vene ne dispozicion cdo kapacitet profesional apo te eksperiences ne kete fushe; shoqeria : “*Miki Consulting*” sh.p.k dhe “*Erald-G*” sh.p.k lidhin kete mareveshje bashkepunimi per tu angazhuar ne realizimin me sukses te kesaj kontrate ne rast te vleresimit te ofertes tone si me te miren.*

- Shtojcën 10 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” të firmosur dhe vulosur nga administratori i shoqërisë “MIKI CONSULTING” SHPK, i cili në Pjesa III “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika B “DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)” ka deklaruar, si më poshtë vijon:

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u> Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve:7</p> <hr/> <p><u>Profili i punonjësve</u> 1. Ing. Gjeto Dukaj-Inxhinier hidroteknik, a. Administrator 20.05.2021-20.05.2026 Ekstrakt QKB, b. License mbikqyrje MK.0758/2 (MEI) c. Diplome Nr. 1053-B, dt. 04.07.1989 (Universiteti Politeknik-Tirane) d. Ekspert per ndihmen e pare dhe nderhyrjen ndaj emergjencave Certefikate Nr. 0003607 (KKSH) d. Përgjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune. Certefikate n. 022SC035 (CCI) e. CV 2. Ing. Gafur Ternova-Inxhinier Topograf a. Kontrata Nr. Rep. 3032 & Nr. Kol. 1675, dt. 14.10.2021 b. License mbikqyrje MK.3869 (MEI) c. Diplome Nr. 993-B, dt. 02.07.1988 (UPT) d.CV</p> <hr/> <p><u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p>

- Shtojcën 10 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” të firmosur dhe vulosur nga administratori i shoqërisë “Erald G” SHPK, i cili në Pjesa III “Kriteret e

Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika B “DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)” ka deklaruar, si më poshtë vijon:

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u> Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve:22</p> <hr/> <p><u>Profili i punonjësve</u> 1. Ing. Gezim Islami-Inxhinier Ndertimi a. Kontrate, Nr. Rep. 14180 & Nr Kol. 10506, date 05.12.2025 b. Lic. MK.0821/6 (MEI) c. Diplome Nr. 1413, dt. 09.09.1991 (Universiteti Politeknik Tirane) d. CV 2. Ing. Artan Mitrushi-Inxhinier Elektrik a. Kontrate, Nr. Rep. 13121 & Nr Kol. 9726, date 08.11.2025 b. Lic. MK.1728/1 (MEI) c. Diplome Nr. 6120-B, dt. 28.05.1981 (Universiteti Politeknik Tirane) d.CV</p> <hr/> <p><u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p>

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërkohë në nenin 3 “*Parime të përgjithshme*” të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.5. Në nenin 14 “*Operatorët ekonomikë*” të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.

2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës.

Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.1.6. Në nenin 77 “*Kërkesat për kualifikim*” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar përcaktohet se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.1.7. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t’i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.”.

III.1.8. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1, 2, 3, 6 dhe 7, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionarit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese

brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;

l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe/ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe

“j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Për dokumentet e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumente në origjinal ose të njësuara me origjinalin.

Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik, si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”.

III.1.9. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën;

d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.”.

III.1.10. Në nenin 88 “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*” pikat 1, 2 dhe 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”.

III.1.11. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe

specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë të garantojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe të veprojë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.12. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi.

Referuar arsyetimit të autoritetit kontraktor rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes “MIKI CONSULTING SHPK & ERALD-G SHPK” është skualifikuar për mospërbushje të kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 9 “FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, nga anëtari i bashkimi të operatorëve “MIKI CONSULTING” SHPK për personelin kryesor dhe konkretisht për disponimin në stafin e tij rtë 1 (një) inxhinier ndërtimi.

Referuar dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor në pikën 2.3.3 “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 9 “FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi ndër të tjera ka përcaktuar se: “Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si në vijim: “1 (një) inxhinier ndërtimi, 1 (një) inxhinier elektrik dhe 1 (një) inxhinier topograf.”. Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.”.

Ligji për Prokurimin Publik (LPP) në nenin 14, pika 2 e tij ka parashikuar edhe mënyrën e paraqitjes së ofertës nga grupe operatorësh ekonomikë si një kandidat i vetëm. Nga LPP është bërë rregullimi me akt nënligjor i paraqitjes së ofertës nga një bashkim operatorësh ekonomikë dhe është pikërisht nëneni 83, i VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, i cili i jep mundësinë operatorëve ekonomikë për paraqitjen e ofertës si një bashkim operatorësh ekonomikë, duke përcaktuar pjesën e punës, shërbimit ose mallit, që do të kryej secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Në pikën 3, të po këtij neni, përcaktohet edhe mënyra e përmbushjes së kriterëve nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Në rastin konkret bashkimi i operatorëve ekonomikë “MIKI CONSULTING SHPK & ERALD-G SHPK”, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar: Kontratë bashkëpunimi datë

27.03.2026, ndërmjet shoqërisë “MIKI CONSULTING” SHPK dhe shoqërisë “Erald G” SHPK, ku shoqëria “MIKI CONSULTING” SHPK do të realizojë 51 % të shërbimit objekt prokurimi, ndërsa shoqëria “Erald G” SHPK do të realizojë 49 % të shërbimit objekt prokurimi (Neni 4, “Kontributet e palëve”), duke marrë përsipër realizimin e shërbimit sipas Shtojcës 8 “TERMAT E REFERENCËS” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Po ashtu, shoqëritë kanë përcaktuar se, sipas përqindjes së pjesëmarrjes në këtë kontratë, do të kontribuojnë edhe me fuqinë punëtore që do të venë në dispozicion për kryerjen e punimeve, ku referuar Pjesës III “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika B “DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)” të Shtojcës 10 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” të dorëzuar nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “MIKI CONSULTING” SHPK konstatohet se për realizimin e shërbimit objekt prokurimi do të vërë në dispozicion të bashkimit të operatorëve ekonomikë 1 (një) inxhinier hidroteknik dhe 1 (një) inxhinier topograf, ndërsa në Pjesën III “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika B “DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)” të Shtojcës 10 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” të dorëzuar nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Erald G” SHPK konstatohet se për realizimin e shërbimit objekt prokurimi do të vërë në dispozicion të bashkimit të operatorëve ekonomikë 1 (një) inxhinier ndërtimi dhe 1 (një) inxhinier elektrik.

Neni 88, pika 3 e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”.

Në rastin konkret, Komisioni konstaton se, referuar kontratës së bashkëpunimit datë 27.03.2026 dhe kontributit të palëve të përcaktuara në nenin 4 të kësaj kontrate, shoqëria “MIKI CONSULTING” SHPK ka marrë përsipër të kryejë 51 % volumit të shërbimit objekt prokurimi, ndërsa shoqëria “Erald G” SHPK ka marrë përsipër që të realizojë 49 % të shërbimit objekt prokurimi, shërbim i cili referuar Shtojcës 8 “TERMAT E REFERENCËS” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi ka përcaktuar shërbimet që do të kryhen nga secili prej personave të stafit kryesor të propozuar, si në vijim: “... 1. Mbikëqyrësin e materialeve dhe cilësisë që duhet të jetë inxhinier Ndërtimi me licensën profesionale përkatëse, me eksperiencë pune në mbikëqyrje, i cili mban përgjegjësi për zbatimin e projektit sipas kushteve teknike të zbatimit, miratimin e volumeve të punimeve, çertifikatën e pagesës, mbajtjen, kontrollin dhe miratimin e gjithë dokumentacionit, miratimin e ndryshimeve të volumeve, ndjek e miraton cilësinë e punimeve, korespondencën me Bashkinë Shkodër, miraton materialet dhe cilësinë e tyre, ndjek e miraton vendosjen e tyre në objekt dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit.

2. Mbikëqyrësin për punimet elektrike (me kohë të pjesëshme) që duhet të jetë inxhinier elektrik me liçensën profesionale përkatesë, me eksperiencë pune, i cili kontrollon dhe miraton punimet elektrike e objektit dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit.

3. Mbikëqyrësin për punimet topografike (me kohë të pjesëshme) që duhet të jetë inxhinier topograf me liçensën profesionale përkatesë, me eksperiencë pune, i cili kontrollon dhe miraton punimet topografike të objektit dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit. ...”.

Referuar kriterit të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.3 “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 9 “FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, KPP konstaton se numri i punjësve të kërkuar për mbikqyrjen e materialeve është 1 (një) inxhinier ndërtimi. Megjithëse nga bashkimi i operatorëve është përcaktuar ndarja e punimeve të gjithë zërave të preventivit në masën 51 % me 49 %, KPP vlerëson se deklarimi i bërë nga anëtari tjetër i bashkimit të operatorëve “Erald G” SHPK lidhur me punonjësin e kualifikuar 1 (një) inxhinier ndërtimi në Pjesën III “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika B “DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)” të Shtojcës 10 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” të dorëzuar çon në përmbushje të kriterit të kërkuar.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “MIKI CONSULTING SHPK & ERALD-G SHPK” është në kushtet e përmbushjes së kriterit kualifikues të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.3 “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 9 “FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi sa i takon kërkesës për disponimin në personelin kryesor të 1 (një) inxhinieri ndërtimi.

Për sa më lart, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranohet ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “MIKI CONSULTING SHPK & ERALD-G SHPK” në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-79637-03-19-2026 me objekt “Mbikqyrja e punimeve për objektin: Rikualifikim urban bllok pallatesh rruga e “Tafiliceve” (Faza e parë)”, me fond limit 258.833 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “*MIKI CONSULTING SHPK & ERALD-G SHPK*”, si dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë bashkim operatorësh ekonomikë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera
4. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*MIKI CONSULTING*” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

